



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28 Maj 2021

Nr: 377

**VENDIM**

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj zj. Qamile Muda, me funksion Infermiere pranë Qendrës Balneare “Enver Shehu”
- Kërkues:** Komuniteti Shqiptar i Helsinkit
- Ndaj:** Zj. Qamile Muda, me funksion Infermiere pranë Qendrës Balneare “Enver Shehu”
- Baza ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,



Data: 28 Maj 2021  
Nr. 377

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj zj. Qamile Muda, me funksion Infermiere pranë Qendrës Balneare “Enver Shehu”.

## VËREN:

### I

#### Vlerësimi paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me shkresën nr. 299 prot., datë 17.04.2021, protokolluar pranë KQZ me shkresën nr. 4019 prot., datë 20.04.2021, nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) është raportuar një denoncim ndaj z. Qamile Muda, me funksion me funksion Infermiere pranë Qendrës Balneare “Enver Shehu” Llixha Peshkopi, e cila pretendohet se ka qenë pjesëmarrës në një aktivitet elektoral, në kundërshtim me rregullimet e nenit 91, pika 2 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe me vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në këtë denoncim pretendohet se zj. Qamile Muda ka qenë pjesëmarrës në një aktivitet publik të zhvilluar në datën 13.04.2021, nga kandidatët për deputet të Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Lavdrim Krrashi, z. Spartak Koltraka dhe zj. Anisa Xhika, në fshatin Pilafë të Njësisë Administrative Tomin.

Bashkangjitur këtij denoncimi është dërguar si mjet provues një fotografi nga aktiviteti i kandidatëve për deputet z. Lavdrim Krrashi, z. Spartak Koltraka dhe zj. Anisa Xhika.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 7 të ligjit 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe



nxjerrjen e vendimit përkatës.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga kallëzuesi KSHH, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

## II

### Rrethanat e faktit

Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor nuk lejojnë përdorimin e burimeve të organeve publike në mbështetje të kandidatëve, partive politike apo koalicioneve gjatë fushatës elektorale. Në zbatim të këtyre dispozitave është miratuar edhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator mbi “Rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në kallëzimin e datës 17.04.2021, nëpërmjet shkresës nr. 299 prot., protokolluar pranë KQZ me shkresën nr. 4019 prot., datë 20.04.2021, nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) pretendohet se zj. Qamile Muda ka qenë pjesëmarrëse në një aktivitet publik të zhvilluar në datën 13.04.2021, nga kandidatët për deputet të Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Lavdrim Krrashi, z. Spartak Koltraka dhe zj. Anisa Xhika, në fshatin Pilafë të Njësisë Administrative Tomin. Sipas denoncuesit, kjo bie në kundërshtim me nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor, si dhe me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri me shkresën nr. 5118 prot., datë 11.05.2021, i ka kërkuar zj. Qamile Muda, informacion sqarues në lidhje me pjesëmarrjen e saj në aktivitet.

Nëpërmjet shkresës së saj datë 17.05.2021, protokolluar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 5118/1 prot., datë 19.05.2021, jemi informuar se zj. Qamile Muda në datën 13.04.2021, ditën kur është zhvilluar aktiviteti, ka qenë në punë turnin e dytë, vërtetuar kjo me grafikën e muajit prill dhe me vërtetimin e lëshuar nga drejtori z. Arben Keshi i Qendrës Balneare “Enver Shehu” Peshkopi. Për sa më sipër, zj. Qamile Muda sqaron se, e ndodhur jashtë orarit zyrtar të punës ka marrë pjesë në takimin e organizuar në fshatin Pilafë.



### III

#### Analiza ligjore

Referuar nenit 91, pika 1 të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”*.

Po ky nen, në pikën 2 të tij përcakton se “burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe i organizuar brenda orarit mësimor i nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Referuar pikës 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Regullator në KQZ, *“Kryeministri, administrata e tij, Zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësministri, administrata e tyre, kryetari i bashkisë zëvendësit dhe administrata e tij, Prefekti dhe administrata e tij, drejtori i përgjithshëm i agjencive apo institucioneve në varësi të Kryeministrit, Këshillit të Ministrave ose Ministrit, drejtori i përgjithshëm, drejtorët e departamenteve, drejtorët e drejtorive dhe administratat respektive, drejtuesit dhe anëtarët e organeve kolegjiale, enteve, bordeve, çdo drejtues i shoqërive tregtare në administrim nga shteti si edhe në çdo ent ku shteti zotëron aksione e kapitale/kuota apo emëron shumicën e organit mbikëqyrës ose të organit administrues, titullari dhe zëvendësit e tij për ndërmarrjet shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendimi”*.

Lidhur me rastin objekt kallëzimi, kallëzuesi pretendon se zj. Qamile Muda ushtron detyrën si infermiere pranë Llixhave Peshkopi. Për këto arsye, KSHZ ka kërkuar informacion nëse zj. Qamile Muda ishte e punësuar pranë këtij institucioni dhe të jepte sqarim në lidhje me aktivitetin ku ajo kishte marrë pjesë. Gjatë hetimit administrativ rezultoi e provuar se zj. Qamile Muda ushtron detyrën e pretenduar nga denoncuesi dhe ka shkuar në aktivitetin e zhvilluar nga kandidatët për deputet jashtë orarit zyrtar të punës.



Referuar nenit 6, pika 4, të vendimit nr. 9/2020 përcaktohet se "Punonjësi i administratës shtetërore, vetëm pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje", Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson së pjesëmarrja e zj. Qamile Muda në aktivitetin me pjesëmarrës kandidatët për deputet, nuk bie në kundërshtim me nenin 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor dhe dispozitave të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në KQZ, pasi është kryer jashtë orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore.

Sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ nuk rezultoi e provuar se zj. Qamile Muda është në shkelje të neneve 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në KQZ. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga KSHH pasi në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se, veprimtaria e zj. Qamile Muda nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në KQZ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja "dh", "f", "n", pika 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

### **V E N D O S:**

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj zj. Qamile Muda.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.



Data: 28 Maj 2021  
Nr. 377

Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj zj. Qamile Muda, me funksion Infermiere pranë Qendrës Balneare "Enver Shehu".

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 28 Maj 2021  
Nr. 377

Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj zj. Qamile Muda, me funksion Infermiere pranë Qendrës Balneare “Enver Shehu”.